

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Anita Krasniqi Prenaj, me sekretaren juridike Fexhrie Tashevci, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.A., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore nga Prishtina, PP.nr.176/18, të datës 31.01.2018, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 326 par. 3 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor: dënim me gjobë, me datë 08.05.2018, mori:

A K T G J Y K I M

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.176/18, të datës 31.01.2018, gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

E.A., nga i ati E. dhe e ëma I., e gjinisë Sh., i lindur më datë ..., me nr. personal ..., me vendbanim në fshatin K. e E., Komuna e S., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 18.03.2017, në ora 02:15 dhe në ora 04:57, në pompën e derivateve P. në fshatin V. – Komuna e F.K., në vazhdimësi, përmes largimit siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, ashtu me veturën e tipit Audi A3, me ngjyrë të kuqe, me targa të regjistrimit ..., pasi ka kërkuar naftë në vlerë 20€, është larguar me vrull pa paguar, po ashtu edhe pas kërkesës për tu furnizuar me 26€ naftë, largohet pa paguar, me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë 46€.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 326 par. 3 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 81 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform neneve 7, 17, 21, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I akuzuari E.A. dënohet me gjobë në shumë prej 250€ (**dyqind e pesëdhjetë euro**), të cilën mund ta paguaj me dy (2) këste mujore në afatin ligjor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20€ të gjobës.

I akuzuari obligohet që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20€, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasuroro – juridike, udhëzohen në kontest juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.nr.176/18, të datës 31.01.2018, ka akuzuar E.A., se ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 326 par. 3 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhit ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si kallëzimi penal 2017-AE-0335, të datës 11.01.2018, deklarata e të dëmtuarit, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 të KPPK-së.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par. 2, të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË P.nr.505/18, të datës 08.05.2018

**Sekretarja Juridike
Fexhrie Tashevc**

**G j y q t a r j a
Anita Krasniqi Prenaj**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.